

Dr. Musli Vërbani

Tregime të grave në Kur'an dhe të historisë së lavdishme Islame

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime të grave në Kur'an dhe të historisë së lavdishme Islame


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



Tregime të grave në Kur'an dhe të historisë së lavdishme Islame



Hava është nëna e njerëzimit.
Ajo jetonte në Xhenet.
Hava shëtiste nëpër kopsht.
Hante nga frutat e xhenetit.
Ulej në brigjet e lumenjve.
Lumenjtë ishin të mrekullueshëm.
Lumenjtë ishin plot me gurë të çmuar.
Ajri i freskët dhe i pastër buronte pandërprerë.
Në të kishte zogj dhe lule.

Havaja gjithnjë kalonte pranë një peme që gjendej në mes të Kopshtit.
Kjo pemë ishte shumë e bukur dhe plot me fruta.
Havaja vetëm e shihte atë, pasi Allahu ia kishte ndaluar asaj që t'i afrohej asaj peme.
Havaja vetëm e shihte atë, pasi Allahu ia kishte ndaluar asaj që të hante nga frytet e saj.

Në fund Hava gaboi dhe e ngrëni pemën e ndaluar.
Ajo më pas u pendua, e Zoti ia pranoi pendimin e saj.
Zoti e zbriti në tokë.
Ajo lindi fëmijë djem dhe vajza.
Prej Nënës së quajtur Hava u shtua njerëzimi.

Haxherja është nëna e Ismailit.

Haxherja ishte shembull i besimtares së vërtetë.

Shembull në mbështetjen në Zotin dhe simbol i dorëzimit të plotë në Zotin e Madhërishëm.

Shembull në tejkalimin e vështirësive dhe pengesave gjatë jetës.

Ibrahimi a.s. e dërgoi para një lugine të shkretë, pa njerëz, pa bimë, pa ujë dhe pa asgjë tjetër.

Haxherja e pyeti Ibrahimin a.s.:

- A Allahu të ka urdhëruar kështu?

Ibrahimi i tha: - Po.

Haxherja i tha: - Atëherë Ai nuk na humbë neve! Nuk kemi për të vdekur atëherë.

Ibrahimi a.s. u largohet dhe i lë të vetmuar Haxherën me fëmijën e saj Ismailin.

Haxherja i jepte gjë Ismailit dhe pinte nga uji që ia kishte lënë, por kur uji u harxhua dhe fëmija ndiente etje, puna ndryshoi. Haxherja filloi ta shikonte fëmijën me dhembshuri madje nga dhimbja e madhe për të nuk mund ta shikonte.

U nis në drejtim të kodrës Safa. Nuk gjeti asgjë.

U kthye dhe shkoi në drejtim të kodrës Merva. Prapë nuk gjeti asgjë.

U nis në drejtim të kodrës Safa. Nuk gjeti asgjë.

U kthye dhe shkoi në drejtim të kodrës Merva. Prapë nuk gjeti asgjë.

U nis në drejtim të kodrës Safa. Nuk gjeti asgjë.

U kthye dhe shkoi në drejtim të kodrës Merva. Prapë nuk gjeti asgjë.

U nis në drejtim të kodrës Safa. Nuk gjeti asgjë.

Duke u kthyer në drejtim të foshnjës sheh diçka të habitshme.

Ismaili buzëqesh sepse meleku pranë tij e kishte afruar ujin.

Haxherja u gëzua pa masë, u afrua te uji. Uji gurgullonte me të madhe.

Haxherja dhe djali i saj Ismaili a.s. pinë nga uji i zemzemit dhe i shpëtuan vdekjes me anë të kësaj mrekullie hyjnore.

Gruaja e Imranit

Ishte mëngjes.

Gruaja e Imranit u hidhte ushqim zogjve në oborr.

Sheh diçka interesante e cila e preku shumë.

Mbi degën e pemës zogjtë kishin ndërtuar një fole.

Zogu mëmë shkonte e vinte.

Mundohej për të gjetur ushqimin për zogjtë e saj të vegjël.

I ushqente vetë ata me kujdesin më të madh.

Kjo pamje i kishte zgjuar fort ndjesitë e saj prej gruaje dhe me gjithë moshën e thyer, nisi t'i lutej Zotit.

Dëshira për t'u bërë nënë ishte e papërballueshme brenda saj.

Lutja e saj me lot në sy ishte e dëlirë dhe e sinqertë.

Zoti e pranoi menjëherë lutjen e saj.

Ditën që e mori vesh se ishte shtatzënë, gati sa nuk fluturoi prej gëzimit.

Ajo ishte një grua e mirë dhe e devotshme,

me ndjenjën e përkushtimit, u përkul me falënderim para Zotit me lutjen:

“Zoti im! Këtë fëmijë që kam në bark, ta kam dhuruar Ty!

Kur të rritet, do të të shërbejë Ty me gjithçka.

Të lutem, o Zot, pranoje këtë kushtim timin!

Padyshim që Ti je Ai që dëgjon lutjet, e i di më së miri qëllimet.”

Vajzën të cilën e lindi e emëroi me e emrin Merjem.

Gruaja e Imranit ishte nga një fis fisnik.
Ajo dëshironte të lind një djalë që ai të kujdesej për shtëpinë e shenjtë në Jerusalem.
Kur lindi vajzë e emëroi me emrin **Merjem**.

U lut te Zoti i Madhëruar që ta ruajë vajzën nga shejtani i mallkuar.
U lut te Zoti i Madhëruar që t'i ruaj pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar.
Zoti i Lartmadhëruar ia pranoi lutjen.
Kujdesin për vajzën Merjem e mori Zekerijai a.s.

Zekerijai ishte pejgamber.
Zekerijai a.s. çdo ditë shkonte në shtëpinë e shenjtë për t'i dërguar ushqim.
Kur Zekerijai a.s. shkonte te Mejremja, në dimër shihte frutat e sezonit veror.
Kur Zekerijai a.s. shkonte te Mejremja, në verë shihte frutat e sezonit dimëror.

E pyeti Merjemen:
- Prej nga këto pemë?

Merjemja iu përgjigj:
- Nga Zoti i Madhëruar.
Allahu furnizon kë do pa llogari.

Zekerijia a.s. e kuptoi se Mejremja ishte e furnizuar me pemë prej Zotit të Madhëruar.

Zekerijai kishte një dëshirë që pas vete të ketë trashëgimtar të mirë.
Kishte një dëshirë që pas vete të ketë pejgamber.
Iu lut Zotit t'ia falë një fëmijë.
Lutja iu pranua.
Fëmijën të cilin ia dhuroi Zoti e emëroi me emrin **Jahja**.

Sara ishte gruaja e Ibrahimit a.s.
Ajo ishte sterile.
Një ditë Ibrahim pa tre burra duke ecur.
Ato tre burra ishin Melekë.
Të tre ishin në formë njeriu, të rinj, të bukur.
Ata ishin Xhibrili, Israfil dhe Mikaili.
Ibrahimi a.s. kishte dëshirë t'i nderojë musafirët.
I ftoi dhe shkuan së bashku në shtëpinë e tij.
Atyre u përgatiti ushqim.
Therë një viç të majmë dhe u fërgoi mish mbi zjarr.
Ushqimin e ofroi para musafirëve.
Ata nuk e shtrinë dorën mbi ushqimin.
Ibrahimi a.s. filloi të dyshojë dhe të frikësohet prej tyre.
Pastaj kuptoi se ata tre burra ishin melekë.
Melekët kishin ardhur për dy lajme.
Lajmi i parë: t'i tregojnë se do ta dënonin popullin e Lutit a.s.
Lajmi i dytë: Melekët e përgëzuan se do t'i lind një djalë.
Sara dëgjoi bisedën e tyre.
Ajo qeshte e habitur.
Tha: - Si është e mundur të lind fëmijë kur unë jam plakë.
Melekët thanë: - **Zoti është i Plotfuqishëm të krijoj çdo gjë në çdo kohë.**

Asija ishte një besimtare e devotshme.
Ishte e bukur, e ëmbël dhe e dhimbsur.
Burri i saj ishte Firauni.
Firauni ishte pabesimtar.

Firauni ishte mizor dhe i pamëshirshëm.
Faraoni e kuptoi se Asija i kishte besuar Musait.
Ajo nuk e fshehu këtë të vërtetë dhe tha me zë:
- Po, edhe unë i besova Zotit të Musait!.

Asijën nuk e mashtroi pasuria e pafund e Firaunit që të bëhej pabesimtare.
Pushteti i Firaunit nuk e mashtroi të mos jetë e devotshme ndaj Krijuesit.
Dhuratat e shtrenjta nuk e gëzuan më shumë se besimi në Zot.
Bukuritë e kësaj bote nuk e mashtruan që ta harrojnë botën tjetër.
Jeta në pallate luksoze nuk e mashtroi që të mos kërkoj shtëpi në xhenet.

Gjatë torturave e bëri një lutje:
**“O Zoti im! Ndërtoma një shtëpi tek Ti, në Xhenet;
më shpëto nga Faraoni dhe veprat e tij dhe më shpëto nga populli keqbërës!”**
Asija e ngriti kokën lart dhe pa nga qielli, asaj iu hoqën perdet e syve.
Iu tregua pallati me perla të bardha që ishte ndërtuar për të në xhenet.

Ishte një kopsht i bukur.
Ai kopsht ndodhej në mes të pallatit dhe brigjeve të Nilit.
Në atë kopsht ishte gruaja e Faraonit.
Emri i saj ishte Asije.
Si zakonisht ajo kishte dalë për të bërë shëtitjen e mëngjesit.
Ecte e e zgjaste shëtitjen më tepër se zakonisht.
Dëshironte të kishte një fëmijë!
Duke ecur e sheh një sënduk që lundronte në Nil.
Urdhëroi shërbëtorët që e shoqëronin ta merrnin dhe t'ia sillnin atë sënduk.
Dëshironte të dinte ç'kishte brenda një sënduku në mes të lumit.
Kur e hapi, brenda pa në të një foshnje.
Ishte gëzimi më i madh për Asijen.
Me kujdes mori beben në krahë.
Ai fëmijë në sënduk ishte **Musai a.s.**

Nëna e Musait a.s.

Një nënë lindi një fëmijë.
Ai fëmijë ishte Musai a.s.
Nëna e Musait e donte foshnjën e porsalindur.
Ajo ishte e detyruar ta vendoste në sënduk.
Ta hidhte në det që ta shpëtonte nga kthetrat e Firaunit.
Pasi e hodhi në det sënduku kishte shkuar te pallati i Firaunit.
Aty e kishte marr Asija, gruaja e Firaunit.
Nëna e Musait pikëllohet shumë.
Thirri të bijën dhe i tha: - Shko bijë gjer te pallati i Faraonit.
Shih mos merr vesh ndonjë gjë për një bebe mbi ujë.
Çfarëdo që të ketë ndodhur së pari lajmi vjen aty, por kujdes, se mos dyshojnë në ty!

Pas një kohe i vjen vajza në shtëpi.
E thërret nënën e saj dhe i thotë:
- Nënë të kanë thirrur për t'i dhënë gjë foshnjës së porsalindur.

Nëna e Musait shkon dhe i jep gjë dhe Musai e ndjeu qumështin e nënës së tij.
Asija sa nuk fluturonte nga gëzimi.
- Merreni ju lutem këtë fëmijë! Le të rrijë me ju për sa kohë ka nevojë për qumësht dhe unë do ju paguaj shumë mirë për këtë! – i tha Asija nënës së Musait.

Zoti ia kishte kthyer prapë të birin nënës së përmalluar, nën një kujdes e siguri të veçantë.

Fëmija rritej më së miri.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Kështu, Ne e kthyem atë te nëna e vet, që ajo të gëzohej e të mos pikëllohej dhe që ta dinte se premtimi i Allahut është i vërtetë; por, shumica e njerëzve nuk e dinë.”

Gëzimi i Asijes për Musain a.s.

Ishte një foshnje e porsalindur.
 Ajo foshnje lundronte me një sënduk mbi një lum.
 Ajo nuk dinte të drejtonte anije.
 Ajo pa dëshirën e saj ishte vendosur në një sënduk.
 Pastaj sënduku ishte hedhur në lum.
 Sënduku lundronte mbi ujë, e po të përmysej ai fëmijë nuk dinte të notonte.
 As nuk dinte të drejtonte sëndukun mbi ujë.
 Sënduku shkon në breg të kopshtit të Firaunit.
Ai fëmijë ishte Musai.
 Foshnjën e mori në krahët e saj Asija.
 Faraoni u çudit tek pa të shoqen me një foshnjë të vogël.
 Asija e puthte gjithë dashuri.

Faraoni i habitur, iu afrua dhe e pyeti se ç'ishte ai fëmijë?
 Asia i tha se e kishte gjetur brenda një sënduku në breg të lumit,
 Faraoni tha:
 - E në qoftë se është nga Izraelët? Ky fëmijë patjetër duhet të ishte i vdekur!

Duke shtrënguar foshnjën fort Asia thotë:
"Jo! Nuk duhet të jetë prej tyre! Mos e vrit!
Ndoshta bëhet një shkas lumturie edhe për mua, dhe për ty.
Le ta mbajmë, le ta rrisim ne këtë fëmijë.
Të lutem! Ndoshta bëhet i mbarë, bëhet bir për ne!".

Burri i saj vendosi t'ia plotësonte Asijes këtë dëshirë.
 E lejoi ta merrte beben e ta rriste në pallat.
 Asija u gëzua aq shumë sa askush nuk e kishte parë këtë gëzim te Asija.
 Asija u gëzua sikur asaj t'i ishte dhuruar pasuri e pa fund.

Motra e Musait a.s.

Mirjami është motra Musait.

Nëna e saj i thotë:

- Shko bijë gjer te pallati i Faraonit.

Shih mos merr vesh ndonjë gjë për një bebe mbi ujë.

Çfarëdo që të ketë ndodhur, lajmi aty shkon më parë!

Po kujdes, se mos dyshojnë në ty!

Motra e Musait shkoi deri në pallat pa rënë në sy.

Aty mësoi për beben e gjetur.

E pa nga larg, i dëgjoi zërin e të qarat e vazhdueshme prej urisë.

Ky ishte gëzimi më i madhi i motrës për vëllanë, kur e kuptoi se nuk ishte fundosur.

Ky ishte gëzimi më i madhi i motrës për vëllanë, kur e kuptoi se vëllai i saj kishte shpëtuar.

Ky ishte gëzimi më i madhi i motrës për vëllanë, kur e kuptoi se vëllai i saj ishte gjallë.

Mirjami shkon te Asija.

E sheh se ajo ishte e mërzhitur dhe e pyeti:

- Pse je e mërzhitur?

Ajo iu përgjigj:

- Musai nuk pranonte të pijë nga gjiri i asnjërës prej grave të pallatit.

Mirjami i thotë

- E njoh një grua, ndoshta Musai nuk do t'ia refuzonte gjirin e saj.

Vajza shkoi në shtëpi,

e lajmëroi nënën e saj.

Pas një kohe shkuan në pallatin e Faraonit.

Ajo u gëzua shumë që pa të birin dhe filloi ta ushqente dhe të kujdesej për të.

Askush nga familja e Faraonit nuk e dinte se ajo ishte nëna e vërtetë e Musait.

Mirjami, motra e Musait a.s. nuk e la asnjë çast pa e përcjellë situatën e vëllait të saj deri sa e bashkoi me nënën.

Kjo është sakrifica e motrës për vëllanë.

Urtësia e Asijës dhe e Musait a.s. kur ishte fëmijë

Një ditë, Musai u dërgua në dhomën e faraonit.
Firauni e mori në prehër.
Musai ia tërhoqi fort mjekrën Faraonit dhe i shkuli një qime.
Më pas i ra me një shuplakë.
Pastaj e mori kamxhikun që mbante në dorë Faraoni dhe e qëllloi.

Faraoni u nevrikos shumë dhe tha:
“Ja ky qenka armiku që kërkoj unë!..”

Pastaj, Firauni vendosi ta vriste Musain.
Asija, e dëgjoi këtë vendim dhe erdhi me të shpejtë, duke thënë:
“Ai është fëmijë, nuk kupton se çfarë bën! Po deshe, le ta vëmë në provë.”
Le t’i vendosim para:
- Një pjatë me diamante e rubin dhe
- një pjatë me prush.
Nëse fëmija merr diamantet, do të thotë që është i mençur.
Nëse merr prushin, dije se ai është vetëm një fëmijë që s’di se çfarë bën!

Faraoni e pranoi këtë propozim.
Menjëherë i sollën dy pjata:
- Njërën me diamante
- tjetrën me prush.

Musai po e çonte dorën tek pjata me diamante.
Xhibrili a.s. ndërhyri me urdhër të Allahut dhe ia shtyu dorën drejt pjatës tjetër.
Musai kapi një copë prush dhe e futi në gojë.
Gjuha iu dogj dhe kur u rrit nuk i shqiptonte mirë fjalët.
Faraoni tha: - Po, është fëmijë prandaj veptoi ashtu!
Më pas Firauni e fali Musain.

Ishte një popull i quajtur Sebeë.
Mbretëresha e atij populli quhej Belkisë.
Ajo kishte fron të mrekullueshëm.
Ai popull adhuronte diellin në vend të Zotit.

Sulejmani a.s. ishte peygamber.
I shkroi një letër dhe e filloi me **“Bismil-lahi Rrahmani Rrahim”**.
Ia dha Hud-Hudit që t’ia dërgoj Belkises.

Hud-Hudi fluturoi dhe kaloi mbi Qabe.
Arriti tek dhoma e Belkisës.
Ia lëshoi letrën në dhomën e Belkisës.
Me atë letër e ftonte Belkisën dhe popullin e saj ta pranojnë fenë islame.
Belkisja e sheh letrën në dhomën e saj.
I ftoi rojet dhe i pyeti se kush ka hyrë në dhomën e saj dhe e ka lënë atë letër?
Ata iu përgjigjën se nuk e dinë.

Belkisja e kuptoi se çështja është serioze.
I thirri të gjitha shtresat, qeverinë, krerët e ushtrisë dhe dijetarët, dhe u tha:
- O populli im, më ka ardhur një letër ku shkruan: **“Bismil-lahi Rrahmani Rrahim**
kjo letër është nga Sulejmani. Mos u krekosni, por bëhuni musliman.”
I pyeti: - Ç’është bëmë?
- Të luftojmë – tha njëri.
- Lufta është e keqe – tha tjetri.

Belkisja vendosi që të tuboj ari, diamant dhe stoli dhe t’ia dërgoj Sulejmanit a.s.
Sulejmani tha: - Unë nuk dua pasuri dhe nuk e pranoj.

Belkisja e kuptoi se Sulejmani nuk mund të korruptohet, atëherë tha:
- **Unë me Sulejmanin i dorëzohemi Zotit dhe ne jemi muslimanë.**
Belkisja e pranoi ftesën e Sulejmanit.
E pranoi islamin.
Me Belkisën i tërë populli i saj e pranoi fenë Islame.
I gjithë Populli Sebeë, Belkisja dhe Sulejmani a.s. iu dorëzuan Zotit të gjithësisë.

Vajzat e Shuajbit a.s.

Ishte mesnatë.

Musait a.s. i i shkon lajmi se ai duhej të largohej.

Musai a.s. me të shpejtë largohet nga Egjipti.

U nis në drejtim të Medjenit.

Rruga e vështirë e kishte lodhur.

Ishte ndalë pranë një lisi për të pushuar.

Në Medjen i sheh dy vajza me bagëti.

Ata dy vajza ishin vajzat e Shuajbit a.s.

Musai a.s. i pyeti: - Çka keni, çka po pritni?

Ato i thanë: - Kemi një baba të moshuar dhe të pafuqishëm.

Ne jemi të detyruara t'i kullosim e t'u japim ujë vetë bagëtive.

Ne nuk duam të hyjmë mes burrave.

Por presim të largohen ata, pastaj u japim ujë bagëtive.

Për shkak se ata u japin ujë para nesh, ndodh që uji të mbarohet dhe ne nuk mund t'u japim ujë bagëtive tona!

Musai a.s. e kuptoi që vajzat ishin ndalur ngaqë nuk mund të përziheshim me djemtë.

Mori bagëtinë e i çoi te burimi dhe me të shpejtë u kthye.

Musai a.s. u ul pranë një lisi e iu lut Zotit: - **O Zoti im më furnizo me të mirat Tua.**

Atë ditë ato u kthyen më herët, para mbrëmjes.

Babai i pyet: - Pse sot keni ardhur më herët.

Njëra nga vajzat i përgjigjet:

- Përderisa ishim duke pritur në një largësi, ndërsa barinjtë e tjerë u jepnin ujë bagëtive, erdhi një njeri dhe na pyeti, dhe ne i treguam se nuk mund t'u japim ujë bagëtive para se të shkojnë barinjtë nga pusi i ujit. Andaj ai i mori dhe u dha ujë bagëtive. Për këtë ne erdhëm më herët.

Pas një kohe njëra prej vajzave shkon te Musai a.s. dhe i thotë:

- Të fton babai ynë që të të shpërblejë për arsye se na ndihmove që t'i japim ujë bagëtive.

Musai a.s. shkoi në shtëpinë e tyre, ia tregoi ngjarjen e tij.

Shuajbi e dëgjoi me vëmendje dhe i thotë se ke shpëtuar nga një popull kriminel.

Vajza e Shuajbit a.s. e cila u martua me Musain a.s.

Ishte një njeri tepër i moshuar.
Ai njeri ishte pejgamberi Shuajb a.s.
Ai nuk kishte fëmijë djem, por vetëm dy vajza.
Musai a.s. kishte shkuar në Medjen.
Në Medjen takohet me Shuajbin a.s.
Shuajbi a.s. i thotë:
- Unë dëshiroj të martohesh me njërën prej vajzave të mia.
Me kusht që të jesh punëtor i imi tetë vite.
Nëse dëshiron mund të qëndrosh dhjetë vite.

Musai a.s. e pranoi këtë marrëveshje.
Qëndroi në qytetin Medjen dhjetë vite të plota.
Pasi qëndroi disa vite në Medjen,
Musai së bashku me gruan shtatzënë u drejtua për në Egjipt.
Gjatë rrugës, ata u ulën për të pushuar.
Nga larg e sheh një dritë.
Musai mendoi se e pa nga larg një zjarr të madh dhe u nis drejt tij.
Kur mbërriti pranë vendit, nuk gjeti zjarr të vërtetë, por dritë që vinte nga qielli.
Ai dëgjoi një zë që e thërriste:
“O Musa! Vërtet Unë jam Zoti yt!
Hiqi sandalet, se je në luginën e shenjtë Tuva!
Unë të zgjodha ty, prandaj dëgjo mirë se ç’po të shpallet!”.
Allahu i madhëruar i kishte zbritur një dritë në atë vend.
Duke i thënë Musait se e kishte bërë pejgamber.

Ejubi a.s. dhe gruaja e tij

Shejtani e takon bashkëshorten e Ejubit a.s.

E pyet: - Ku e ke bashkëshortin?

Ajo i thotë: - Ai është i sëmure, i shtrirë.

Shejtani i thotë: - Si do të vazhdosh kështu? Dëshiron që ai të shërohet?

Ajo i thotë: - Po.

Shejtani i thotë: - Që të shërohet, ai duhet të heq dorë nga durimi.

E nxitur nga shejtani, pas 18 vitesh gruaja shkon dhe i thotë Ejubit a.s.:

- A je pejgamber i Zotit? – i thotë ajo.

Ejubi i thotë: - Po!

Gruaja i thotë: - Përse nuk i drejtohesh Allahut xh.sh. me lutje që të të shëroj dhe të të nxjerr nga kjo gjendje ku ndodhemi?

Ejubi i thotë: - Sa vite kemi jetuar të lumtur, në bollëk e të shëndetshëm?

Gruaja i thotë: - 50 vite.

Ejubi i thotë: - Sa vite kam që jam kështu i sëmure, pa luks e pasuri?

Gruaja: Me sa më kujtohet 18 vite.

Ejubi: Nëse Zoti na dha të mira për 50 vite, përse të mos durojmë vuajtje po aq vite?

Nuk bëj lutje, deri sa të vuaj aq vite sa kam jetuar në të mira!

Bashkëshortja u zemërua me Ejubin a.s. pasi nuk e mori parasysh këshillën e saj, dhe tha:

- Deri kur do vazhdojmë kështu? Dhe tha diçka që nuk duhej thënë. Filloi disi si një përplasje mes çiftit.

Ejubi i tha: - Ti dëshiron të largohesh nga mëshira e Zotit?

Po u shërova do të godas 100 herë.

Vuajtjet filluan të shtohen, tashmë bashkëshorten e Ejubit a.s. nga frika se mos ajo ua ngjet sëmundjen e Ejubit a.s. nuk e pranonin më në punë.

Ejubin a.s. e braktisën te afërmit, njerëzit, me përjashtim të dy shokëve të tij të ngushtë që e vizitonin.

Gruaja e Ejubit a.s.

Ejubi a.s. ishte i sëmure.

Gruaja e tij përkujdesej për të.

Një ditë gruaja i sjell ushqim më shumë se herët e tjera.

Ejubi a.s. e pyet, ku e ke marr këtë ushqim?

Gruaja e tij nuk i tregoi.

Ejubi a.s. këmbëngul që t'i tregon.

Gruaja i tregon se kishte prerë gërshetat, i kishte shitur dhe me to kishte blerë ushqimin.

Pasi Ejubi a.s. u bind që gjendja kishte shkuar aty ku nuk mban më, iu lut Allahut xh.sh. që ta shërojë.

Pas lutjes që Ejubi a.s. i bëri Allahut xh.sh., Allahu xh.sh. thotë në Kur'an:

“Ne iu përgjigjëm atij nga mëshira Jonë, ia hoqëm ato vështirësi që kishte.”

Allahu xh.sh. i thotë Ejubit a.s.:

“Bjeri me këmbë tokës.”

Me ta goditur tokën, në atë vend doli ujë. Allahu xh.sh. i thotë Ejubit a.s.:

“Ky është ujë i ftohtë për t'u larë dhe për t'u pirë.”

Në atë ujë Ejubi a.s. piu dhe me atë ujë u la.

Pasi Ejubi a.s. piu ujin dhe u la, ai u shërua nga çdo lloj sëmundje.

Zoti i ktheu Ejubit a.s. shëndetin dhe rininë e tij.

Kur u kthye bashkëshortja në shtëpi, me të shikuar u habit dhe tha:

- Mos e ke parë gjë Ejubin a.s. pasi ti i ngjan shumë atij para se të sëmurej?

Ejubi a.s. i thotë: - Nuk më njeh?

Gruaja i thote: - Jo!

Ejubi a.s. i thotë: - Jam unë, Ejubi!

Pas kësaj Allahu xh.sh. Ejubit a.s. ia ktheu pasurinë dhe i dhuroi shumë fëmijë.

Ata lindën 26 fëmijë, djem e vajza.

Po ashtu edhe bashkëshortja e Ejubit a.s. u kthye e re ashtu siç ka qenë para 18 vitesh, dhe kjo si shpërblim për besnikërinë e treguar ndaj Ejubit a.s.

Më parë Ejubi a.s. ishte betuar se kur të shërohet do e godiste bashkëshorten 100 herë, e për këtë betim ai ishte penduar pasi bashkëshortja e tij ishte treguar besnike dhe durimtare. Zoti i thotë Ejubit a.s. që të marr 100 fije bari dhe ta qëllojë me to vetëm një herë gruan e tij.

Allahu xh.sh. thotë;

“E, merre me dorën tënde një deng me fije bari dhe bjeri me to, e mos e thyej betimin.”

Jusufi është rritur pa brenga në pallatin e ministrit.
Zoti i Madhëruar i kishte dhënë bukuri, dituri dhe mençuri.
Bukuria e tij e shtyri gruan e ministrit që të dashurohej në të.
Ajo filloi që të zbukurohej për Jusufin, mirëpo Jusufi a.s. nuk tregonte interesim për të.
Kur e pa Zulejhaja se ai e refuzonte e ftoi në dhomën e saj,
ia mbylli derën e u përgatit që të flejë së bashku me Jusufin.

Jusufi a.s. iku me të shpejtë,
afër derës e takoi ministri.
Ai e kuptoi se Zulejhaja ishte gabim andaj Jusufit i tha:
- Largohu nga ajo, ndërsa gruan e tij e këshilloi që të kërkojë falje për gabimin e bërë.

Në qytet u përhap lajmi.
Lajmi e irritoi Zuejhanë edhe më shumë.
Ajo i ftoi të gjitha gratë e qytetit,
u dha nga një mollë dhe thikë për të qëruar mollët.
Pastaj e urdhëroi Jusufin të hyjë në mesin e tyre.
Kur e panë bukurinë e Jusufit, mbetën gojëhapur.
Ata thanë: - Ky nuk është njeri, me siguri është engjëll fisnik.
I prenë duart e tyre e nuk e ndienin dhembjen.
Dhembjen filluan ta ndiejnë vetëm atëherë kur doli Jusufi a.s.

Edhe pse Jusufi a.s. ishte i drejtë, tradhtia e tjerëve e shtyri atë që pas një kohe të hidhet në burg.

Eminja është e bija e Vehbit.
Ajo u martua me Abdullahun.
Eminja e lindi një djalë.
Pasi i lindi djali e morri beben.
E vendosi foshnjën e porsalindur në prehër.
E përqafoi në duart e saj.
E përqafoi duke thënë:
“Eja, stoli e çmuar e dritës së syve të mi.”
Zoti më dha një thesar që do të dhurojë **mëshirë në të gjitha botët.**
Hyritë e xhenetit i bashkuan të dy duart në lutje.
Melekët e puthën fëmijën.
Pejgamberët në fushën hyjnore e puthën fëmijën.
Qeniet e ndriçuara e puthën fëmijën në ballë, e puthën Dritën.
Me të puthur të fëmijës, të gjithë e lanë beben në duart e Emine dhe shkuan.
Eminja e rriti Dritën e njohur.
Ajo dritë e ka emrin Muhamed.
Muhamedi a.s. është vula e të gjithë pejgamberëve.

Hatixhja i përkiste fesë së Ibrahimit.
 Është gruaja të cilës Zoti për burrë ia zgjodhi Muhamedin a.s.
 Ajo u martua me Pejgamberin a.s.
 Vereka bin Nufejl ishte axha i Hatixhes.
 Ai lexonte në librat qiellor të mëparshëm,
 ku përmendet ardhja e një Pejgamberi të fundit
 dhe këto ia tregonte edhe Hatixhes.
 Ai i kishte treguar mbi cilësitë e këtij Pejgamberi dhe vendin ku do të dalë.

Personi i parë që e ndjeu se Muhamedi a.s. do të jetë pejgamberi i fundit, ishte Hatixheja.
 Ishte e para që ofronte ndihmë dhe mbrojtje për Pejgamberit a.s.
 Ajo ishte personi i parë që shpenzoi nga pasuria e saj për hir të islamit.

Para se të fillonte zbritja e Kur'anit, për çdo ditë udhëtonte drejt shpellës Hira, ku qëndronte Muhamedi a.s.
 Kur ishte takuar me Xhibrilin
 dhe pasi kishte dëgjuar për herë të parë fjalën e Allahut,
 Pejgamberi alejhi selam u kthye i tronditur nga shpella Hira.

Ai i tha Hadixhes: - U tremba.
 Ajo i foli ëmbëlsisht duke e përgëzuar:
“Betohem në Allahun e Lartësuar, se Ai kurrë nuk ka për të të poshtëruar.”
 Për çdo ditë i dërgonte ushqim dhe ia largonte mërzinë.
 Hatixhja i qëndronte në krah Muhamedit a.s.

Hatixhes i lindën shtatë fëmijë, prej tyre katër vajza dhe tre djem.
 Katër vajzat janë: Zejneb, Rukaje, Umu Kulthum dhe Fatime.
 Djemtë që u lindën janë: El-Kasim, Abdullah dhe Tahir.

Ishte një vajze e re.
 Ajo ishte e devotshme.
 Ishte e moralshme.
 E donte jetën.
 Ajo ishte vajza e Ebu Bekrit r.a.
 Ishte gruaja e Muhamedit a.s.
 Emri i saj ishte Aishe.
 Një ditë pejgamberi a.s. i thotë asaj:
 - Mund të më përgjigjesh në një pyetje që do ta parashtroj?
 Ajshja r.a. i tha: - Cila është ajo pyetje?
 Profeti s.a.v.s. filloi t'i lexojë ajetet:
 “O ti pejgamber, thuaju grave tua:
 Në qoftë se e lakmoni jetën e kësaj bote dhe stilit të saj, atëherë ejani, unë po ju jap furnizimin (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e rrugës.
 Nëse e doni Allahun, të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se Allahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira.”

Aishja r.a. e dëgjoi këtë dhe tha:
 “O i dërguar i Allahut,
 Unë e preferoj Allahun, të dërguarin e Tij
 dhe botën e ardhme më shumë se komoditetet e rëndomta.”

Muhamedi a.s. u nda i kënaqur prej përgjigjes së Ajshes r.a.

Aisheja, ajo që transmetoi shumë dije për tek brezat e ardhshme,
 gëzonte dije të thella në çështje të ndryshme fetare.
 Njihte shumë mirë tefsirin e Kur'anit, fikhun, poezitë arabe, etj.
 Aisheja është personi që ka transmetuar më së shumti hadithe nga Pejgamberi a.s.

Halimja është nëna e Muhamedit a.s. për nga qumështi.
Në Meke, kur lindnin fëmijët në qytet, i dërgonin në majat e larta të fshatrave.
Në fshat ajri ishte i pastër.
Uji i kthjellët, ajri i pastër.
Mbi të gjitha fëmija e mësonte theksin e kulluar arab.
Fëmija e mësonte gjuhën e pastër arabe.
Trupi i fëmijëve që në fillim kalitej dhe bëhej i fortë.
Djalin e vogël nuk dëshironin ta merrnin asnjëra prej gjidhënëseve.
Halime bin Sead pranoi që Muhamedin a.s. ta merrte me vete në fshatin e saj.
Halimja ka pasur pak qumësht.
Kur e merr foshnjën Muhamed sheh se gjiri i saj kishte plotë qumësht.
Në shtëpinë e saj shtohet begatia.
Të gjitha të mirat në shtëpinë e saj ishin për shkak të foshnjës Muhamed.
Ajo tokë ka qenë tokë e shkretë dhe e pa bereqet.
Delet asnjëherë nuk ngopeshin në kullosa.
Por kur shkoi fëmija Muhamed a.s. ato u kthyen në kullosa të bereqetshme.

Ishte një vajzë e dashur.

Ajo vajzë ishte Fatimja.

Fatimja ishte e bija e Muhamedit a.s.

Muhamedi a.s. e donte shumë Fatimen r.a.

Sa herë që ajo hynte në dhomën e Muhamedit a.s., ngrihej në këmbë, e puthte dhe i kërkonte që të ulej në vendin e tij.

Një ditë prej ditëve Fatimja hyri brenda dhe e shikoi gjendjen e babait të saj dhe tha:

- Ah Babai im! Çfarë ka ndodhur kështu?

Muhamedi a.s. i kërkoi që të ulet e të mos flet ashtu.

Muhamedi a.s. i kërkoi t'ia afroj veshin, e kur i tha diçka.

Fatimja filloi të qaj.

Më pas Fatimja u qetësua.

Muhamedi a.s. i kërkoi që t'ia afroj përsëri veshin që t'i thotë diçka.

Fatimja filloi të qeshë.

Herën e parë, Muhamedi a.s. i ka treguar se ka ardhur çasti për t'ia dorëzuar shpirtin Allahut xh.sh.

Për këtë Fatimja ka qarë.

Herën e dytë Muhamedi a.s. i ka thënë se personi i parë nga familja që do t'i bashkëngjitet në botën tjetër do të jetë ajo.

Për këtë Fatimja ka qeshur.

Pas gjashtë muajsh vdiq Fatimja.

Ishte bashkëshorte besnike, nënë e përkushtuar.

Lindi dy djem:

Hasanin, të madhin, dhe Husejnin që ishte i vogli.

Muhamedi a.s. me shokët e tij ishte nisur për në Qabe.
Mekasit e ndalën në vendin e quajtur Hudejbije.

Pas negociatave në mes mekasve dhe Muhamedit a.s. u arrit një marrëveshje.
Ajo marrëveshje quhet marrëveshja e Hudejbijes.
Në bazë të kësaj marrëveshje muslimanëve u ndalohej të shkonin në Meke atë vit.
Në marrëveshje parashihej që muslimanët duhet të ktheheshin pa e bërë haxhin.
Pejgamberi a.s. i urdhëroi sahabët që t'i therin kurbanet e haxhit dhe të qetheshin.

Sahabët ngurruan.
Pejgamberi a.s. u hidhërua shumë.
Hyri në çadrën e bashkëshortes së vet.
Bashkëshortja e Muhamedit a.s. e cila ishte te çadra ishte Ummi Seleme.
Ajo e pyeti disa herë se pse ishte aq i hidhëruar.
Pejgamberi iu përgjigj:
- Mbaruan muslimanët!
U thashë t'i therin kurbanet, por ata nuk po veprojnë.
Ummi Selemeja i tha:
- O i Dërguar i Allahut, mos i qorto, pasi në brendinë e tyre kanë shumë hidhërim nga munda që i ke dhënë ti vetes nga marrëveshja dhe kthimi i tyre prapa pa e çliruar Mekën.
O Pejgamber i Allahut,
dil dhe mos fol me askënd,
there kurbanin tënd dhe
qethi flokët tua.

Pejgamberi a.s. ashtu veproi.

Pas tij të gjithë besimtarët i therën kurbanet dhe i qethën flokët.

Esma, pronarja e dy mbulesave

Esma është e bija e Ebu Bekrit r.a.

Muhamedi a.s. me Ebu Bekrin nisen për në Medine.

Rrugës për në Medine ndalen në shpellën Thevr.

Muhamedi a.s. me Ebu Bekrin qëndruan tri ditë.

Abdullahu gjatë ditës qëndronte në mesin e Kurejshitëve dhe dëgjonte se çfarë po përgatitej kundër Pejgamberit a.s.

Abdullahu natën u raportonte.

Fuhejri kulloste bagëtinë dhe në mbrëmje i kalonte pranë tyre që ata të milnin qumësht.

Në mëngjes, kur Abdullahu i linte dhe shkonte në Mekë, Fuhejri mbi gjurmët e këmbëve të tij kalonte bagëtinë për të mbuluar gjurmët.

Pas tri ditësh, shkon njeriu që kishin marrë me pagesë me dy devetë e tyre dhe një deve për vete.

Erdhi edhe e bija e Ebu Bekrit, Esma.

Esma me vete kishte sjellë ushqim dhe ujë të nevojshëm për udhëtim.

Ajo kishte harruar të merrte litarin për të lidhur te deveja bohçen me ujë dhe ushqim.

Esma mendoi pak, iu kujtua që ta shqyejë mbulesën e vet dhe me të t'i lidhë gjërat ndaj e shqeu në dy pjesë një pjesë të tepërt të robës.

Me njërën pjesë përforcoi ushqimin.

Me pjesën tjetër u mbështoll vetë.

Për këtë arsye Esma bint Ebi Bekri u quajt **“pronarja e mbulesës”** (dhatun-nitak).

Ishte një familje muslimane.
Ajo familje ishte prej familjeve të para të cilat e kishin pranuar Islamin.
Nëna në atë familje quhej Sumeje.
Baba i asaj familje quhej Jasir.
Sumeja është nëna e Amarit.
Familja e Jasirit u sprovua e tëra për çështjen e fesë.
Familja e Jasirit tërë jetën e kishte në shërbim të çështjes islame.
Ata duruan torturat çnjerëzore.
Secili i jepte kurajë tjetrit, duke përçar shpirtin e qëndresës dhe të durimit.
Jasiri është personi i parë në islam që ndërtoi xhami.
Prindërit dhe fëmijët e tyre ishin bashkuar dhe i shërbenin çështjes islame.
Sumeja është e para dëshmore në islam.
Burri i saj, Jasir ibnu Amir El-Kendij është dëshmori i parë në islam.
Zoti i Madhëruar thotë në Kur'an:
**“Kursesit mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut.
Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre.”**
Ata dhanë jetë për fenë Islame.

Shërbëtorja e vajzës së Firaunit

Na ishte një shërbëtore e vajzës së Faraonit.

Ajo një ditë duke ia krehur flokët bijës së Faraonit i ra krehri në tokë.

Ajo duke e marrë atë tha:

- **Bismilah (me emrin e Allahut).**

Vajza tha: - Në emër të babit tim a?

Ajo tha:

- Jo, babi yt nuk është zot. Por Zot është Krijuesi im, i babit tënd, dhe Zot i gjithësisë.

Vajza tha:

- Unë dua ta lajmëroj babin tim për këtë që ti po thua.

Tha:

- Bëja me dije.

Ajo e lajmëroi Faraonin.

Firauni e thirri shërbëtoren dhe i tha:

- A është e vërtetë se ti beson në tjetër zot pos meje?

Tha:

- Po, Zot është vetëm Allahu. Ai është Zoti im, i yti dhe i gjithë botëve.

Faraoni porositi të ndizet një zjarr, e pastaj i tha asaj:

- Shko merri fëmijët dhe sjelli këtu.

Ajo i solli fëmijët.

Faraoni tha:

- Tërhiq nga besimi në tjetër zot.

Ajo tha: - Jo kuurrë!

Ai tha: - Hidhjani fëmijën në zjarr.

E hodhën të parin. Ajo nuk u tërhoq.

E hodhën të dytin. Ajo nuk u tërhoq.

Kur i tha që ta hedhin edhe atë që e kishte në krah, ajo u ndal.

Në atë moment fëmija çoi kokën dhe tha:

- **Nënë mos u tërhiq ngase nuk ka zot tjetër pos Allahut.**

Atëherë ajo u hodh në zjarr me gjithë foshnjën e saj.

Nga tymi dhe shkrumbi i tyre u parfumuan qiejt.

Ai parfum edhe sot qëndron lartë në qiej.

Ibrahimi a.s. shkon për të vizituar Ismailin a.s.

Ismailin nuk e takon në shtëpi.

E takon gruan e Ismailit a.s.

E pyet gruan e Ismailit

për gjendjen ekonomike të tyre,

Ajo i ankohet dhe i thotë:

- Ne jemi në gjendje të vështirë, as që mundemi të mbijetojmë.

Ibrahimi i thotë:

- Kur të vijë burri yt, përcille selamin tim dhe thuaj se të kam thënë që ta ndërrojë pragun e shtëpisë.

Kthehet Ismaili në shtëpi.

E pyet gruan: - Mos vallë ka qenë ndokush?

Ajo i përgjigjet:

- Po, ka ardhur një plak dhe me pyeti për ty dhe për gjendjen tonë.

E unë i thashë: - Jetojmë me përpjekje dhe vështirësi të madhe.

- Po a të ka porositur diçka?

Ajo i tha:

- Më ka thënë të ta përcjell selamin dhe të të them: Ndryshojë pragun e shtëpisë.

Ismaili thotë:

- Po ai është babi im dhe paska ardhur për të thënë që të të lëshoj dhe të të dërgoj në familjen tënde.

E shkurorëzon dhe martohet me një grua tjetër.

Gruaja e Ismailit a.s.

Ibrahimi a.s. shkon për të vizituar Ismailin a.s.

Ismailin nuk e gjen në shtëpi.

E takon gruan e Ismailit a.s.

Hyn në shtëpi dhe e pyet gruan për Ismailin.

Ajo i thotë:

- Ka dalë të punojë për familje.

Ibrahimi e pyet:

- Si e keni gjendjen, si po jetoni?

Ajo i përgjigjet:

- Elhamdulillah! E falënderojmë Allahun, mirë jemi duke jetuar.

Ibrahimi i thotë:

- Kur të vjen Ismaili përcjellja selamin tim dhe thuaji që ta forcojë pragun e shtëpisë.

Ibrahimi bën lutje: **“O Zoti im, bekoji ata me mish e me ujë”**.

Kur Ismaili kthehet në shtëpi e pyet bashkëshorten se a ka qenë ndokush.

Ajo i përgjigjet se ka ardhur një njeri i moshuar, me pamje të mirë. Më pyeti për ju dhe i tregova. Më pyeti se si jetojmë e unë i tregova se jemi duke jetuar mirë.

Pastaj Ismaili a.s. e pyeti bashkëshorten e tij se a kishte lënë ndonjë porosi.

Ajo i thotë:

- Po, më porositi që të ta përcjell selamin dhe që ta forcosh pragun e shtëpisë tënde.

Ismaili a.s. i thotë:

Ai ishte babai im e ti je pragu im dhe më ka urdhëruar që të të mbaj nën kurorë.

Nëna dhe foshnja

Një nënë ishte duke i dhënë gjë foshnjës së vet.
Kalon aty pari një i pasur hipur në një deve të shtrenjtë e të bukur.

Nëna e tij tha:

- **O Allahu im, bëje djalin tim sikurse ky!**

Fëmija e la gjirin, u kthye nga njeriu, e shikoi dhe tha:

- **O Allahu im, mos më bëj si ai!**

Pastaj u kthye nga gjiri dhe vazhdoi të thithë.

Nëna habitet me reagimin e foshnjës së saj.

Pastaj njerëzit kaluan me një robëreshë.

Robëreshën e rrihnin dhe i thoshin:

- Ke bërë pandershmëri, ke vjedhur.

Ajo thoshte:

- **HasbijAllahu ve ni'mel-vekil.**

(Allahu më mjafton për gjithçka dhe Ai është mbrojtësi më i mirë)

Nëna e foshnjës tha: - **O Allahu im, mos e bëj djalin tim si kjo.**

Foshnja e la thithjen dhe shikoi nga ajo e tha:

- **O Allahu im, më bëj mua si ajo.**

Foshnja është arsyetuar duke thënë:

- Njeriu i pasur në deve ishte tiran, andaj dhe kam thënë, o Allahu im, mos më bëj si ai!
Mos më bëj tiran.

- Robëresha për të cilën thoshin se ka bërë pandershmëri, në të vërtetë ajo nuk ka bërë, thoshin se ka vjedhur, por kanë shpifur për të, për këtë arsye thashë: O Allahu im, më bëj mua si ajo.

Mbretëresha e bukurisë në zjarr

Në kohën e Muhamedit a.s. ishte një grua.
I thoshin Ummi Xhemil.
Umi Xhemile do të thotë mbretëreshë e bukurisë.
Ajo rridhte prej një familjeje fisnike të Mekës.
Umi Xhemile kishte pasuri.

Nuk pajtohej me faktin se Muhamedi a.s. ishte ngritur kundër besimit të tyre pagan.
Besimi Islam dëshironte t'i barazonte robërit e të varfrit me klasën e lartë sunduese.

Ummi Xhemil kishte rreth qafës së saj një gjerdan të çmueshëm,
atë do ta shkrinte në armiqësinë kundër Muhamedit a.s.
Ummu Xhemili, për çdo natë mblidhte ferra dhe degë me gjemba.
I bënte grumbull të madh.
I lidhte në kurriz dhe i shpërndante nëpër rrugët nga kalonte i Dërguari i Allahut.
I Dërguari i Allahut kalonte mbi to.
Kur Muhamedi a.s. shkelte mbi to, dukej sikur shkelte mbi mëndafsh.

Kaloi një kohë.
Mbretëresha e bukurisë u shëmtua.
E humbi edhe vetëdijen.
Duke bartur dru i është lidhur litari në fyt dhe ka vdekur.
Allahu xh.sh. në ditën e Llogarisë përfundimtare atë gjerdan të artë do t'ia zëvendësojë
me një litar të përdredhur nga flaka e Xhehennemit.

Gruaja e Ebu Lehebit

Kishte zbritur sureja Ebu Leheb.

Ummi Xhemile ishte tërbuar.

Me nxitim shkon në oborrin e Qabesë për ta takuar Muhamedin a.s.

Nuk kishte synim për ta përshëndetur por për ta sulmuar me gurë.

I Dërguari i Allahut ndodhej në Qabe bashkë me Ebu Bekrin.

Ebu Bekri r.a. e vërejti ardhjen dhe zemërimin e saj dhe i thotë Muhamedit a.s.:

- O i Dërguari i Allahut!

Kjo është Ummu Xhemil.

Është një femër e tërbuar!

Kam frikë se do të të shohë dhe do të të mendojë!

Sikur të ngriheshe e të ikje pa ardhur ende e pa të bërë ndonjë të keqe kjo grua!

Pejgamberi i tha: - Ajo s'më sheh dot mua!

Umi Xhemile u afrua pranë tyre.

Ummi Xhemil nuk e pa dot të Dërguarin e Allahut.

Ajo vetëm sa lëshoi ca përçartje pranë Ebu Bekrit r.a. dhe u largua.

HAVA	7
HAXHERJA.....	8
GRUAJA E IMRANIT.....	9
MERJEMJA	10
SARA.....	11
ASIJA.....	12
ASIJA DHE MUSAI A.S.	13
NËNA E MUSAIT A.S.	14
GËZIMI I ASIJES PËR MUSAIN A.S.	15
MOTRA E MUSAIT A.S.	16
URTËSIA E ASIJËS DHE E MUSAIT A.S. KUR ISHTE FËMIJË	17
BELKISJA	18
VAJZAT E SHUAJBIT A.S.....	19
VAJZA E SHUAJBIT A.S. E CILA U MARTUA ME MUSAIN A.S.	20
EJUBI A.S. DHE GRUAJA E TIJ.....	21
GRUAJA E EJUBIT A.S.	22
ZULEJHAJA	23
EMINJA	24
HATIXHEJA R.A.	25
AISHJA R.A.	26
HALIMJA	27
FATIMJA R.A.	28
UMMI SELEME	29
ESMA, PRONARJA E DY MBULESAVE.....	30
SUMEJA	31
SHËRBËTORJA E VAJZËS SË FIRAUNIT	32
GRUAJA E ISMAILIT A.S.	33
GRUAJA E ISMAILIT A.S.	34
NËNA DHE FOSHINJA	35
MBRETËRRESHA E BUKURISË NË ZJARR.....	36
GRUAJA E EBU LEHEBIT	37